

D E K R E T
Nr.2064, datë 22.4.1998

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR ORGANET LOKALE
TË PUSHTETIT**

Në mbështetje të nenit 28, pika 3, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", si dhe të nenit 7, të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal"

D E K R E T O J:

Neni 1

Zgjedhjet e pjesshme të parakohshme për kryetar komune dhe kryetar bashkie të zhvillohen ditën e diel, datë 21 qershor 1998.

Neni 2

Zgjedhjet të zhvillohen në komunat Lazarat (Gjirokastrë), Progër (Devoll), Lurë (Dibër), Dhiver (Sarandë), Zavalinë (Elbasan), Gjergjan (Elbasan), Sineballaj (Kavajë), Bushtricë (Kukës), Greshicë (Mallakastër), si dhe në bashkitë Vlorë, Reskovec, Vorë, Patos, Ura Vajgurore, Shijak dhe Kavajë.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani